



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.26, datë 05.03.2021

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 2 DHE KATUND I RI, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit”, i ndryshuar, të raporteve të Komisionit të Posaçëm, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative nr.2, sipas aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative Katundi i Ri, sipas aneksit 2 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Miratimin e raportit me nr. 2145/6 prot., datë 04.03.2021 të Komisionit të Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative nr. 2 dhe Katundi i Ri, Bashkia Durrës, bashkëlidhur.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Proçesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinarë dhe Emergjencave Civile.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.03.2021

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.2

NR	KODI GIS	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	24277	49517	NEKI	ABAZ	KODRA	PRISHJE	PO
2	25595		RAMIZ	SHYQRI	ÇURRI	PRISHJE	PO



ANEKSI 2. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI

NR	KODI GIS	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	40854	32823	TAHIR	ISMAIL	KOKICI	PRISHJE	PO
2	40979	36560	NDOC	MIRASH	CUMRAKU	PRISHJE	PO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. 7145/6 Prot.

Durrës, më 04/03 / 2021

MIRATOI

ZËVENDËSKRYETAR

Emirjana Sako

RAPORT

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT
NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR.2 DHE KATUND I RI, BASHKIA DURRËS, QË
DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR
BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E
TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Referuar Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara në Njësitë Administrative Nr.2 dhe Katund i Ri sipas relacionit si më poshtë:

Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, ka regjistruar dhe përpunuar aplikimet për përfitimin nga programet e rindërtimit në një sistem elektronik. Kjo zyrë ka bërë përpunimin e kërkesave të plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 13, të VKM-së nr.5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, duke bërë

klasifikimin e aplikantëve për përfitimin e grantit të rindërtimit për banesat individuale në Njësitë Administrative Nr.2 dhe Katund i Ri, Bashkia Durrës, banesa të cilat sipas ekspertizës së thelluar hartuar nga Instituti i Ndërtimit, është vendosur prishja e tyre.

Ky dokumentacion dhe kjo listë me klasifikimin e aplikantëve i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

Për sa më sipër, lista e subjekteve përfitues, pjesë përbërëse e këtij vendimi është si aneksit 1 dhe 2 të bashkëlidhur:

Raporti nr. 943/4 prot., datë 23.02.2021 për Njësinë Administrative Nr.2 : 2 aplikantë përfitues për grantin e rindërtimit të banesave individuale.

Raporti nr. 943/5 prot., datë 23.02.2021 për Njësinë Administrative Katund i Ri : 2 aplikantë, përfitues për grantin e rindërtimit të banesave individuale.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm, kërkohet miratimi i listës së përfituesve nga granti i rindërtimit, sipas listës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Të sigurtë në bashkëpunimin Tuaj,

KOMISIONI I POSAÇËM:

Florian Tahiri	Kryetar	
Fermal Lufo	Anëtar	
Andri Cerri	Anëtar	
Diana Mandia	Anëtare	
Klara Agasi	Anëtare	
Edvin Hysi	Anëtar	
Afroviti Manthjo	Anëtar	
Ilir Ngresi	Anëtar	
Kujtim Shahini	Anëtar	

BASHKIA DURRËS
D. 23.03.21 Nr. 1209/15



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 12/prot.
3

Durrës, më 23.03.2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 26 datë 05.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative Nr. 2 dhe Katund i Ri, Bashkia Durrës që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

